

VENDIM
Nr. 94, datë 2.4.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 193, DATË 18.9.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘HPG ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 874/1 prot., datë 31.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.9.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘HPG Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “HPG Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 18.9.2024, ka licencuar shoqërinë “HPG Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar, me kushtet përkatëse.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 15.8.2025, vendosi të ndryshojë pikat 2 dhe 3 të vendimit të sipërcituar, ku në pikën 2 të këtij vendimi u përcaktua detyrimi që shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 16.12.2025, ndërsa në pikën 3 u përcaktua detyrimi të dokumentojë në ERE testimin e veprës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit.

- Gjithashtu, në pikën 5, të vendimit nr. 193/2024, përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast se depozitohet/konstatohet një dokumentacion i ndryshëm nga ai që ka shërbyer për këtë vendimmarrje”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2711 prot., datë 22.10.2025, shoqëria ka raportuar përfundimin e punimeve, kryerjen e testeve nga OSSH sh.a. dhe fillimin e prodhimit të energjisë elektrike më datë 25.8.2025, në bazë të kontratës me FTL sh.a.

- Me shkresën nr. 2711/1 prot., datë 13.11.2025, ERE i ka kërkuar shoqërisë informacion në lidhje me testimin e veprës.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 874 prot., datë 10.3.2026, shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr. 1405/3 prot., datë 6.3.2026, me të cilën është përcjellë Raporti i Testimit i impiantit FV “HPG Energy” (2 mw), i kryer në terren nga grupi i punës. Sipas këtij raporti, testimi është zhvilluar në datat 26–27.1.2026, në vijim të kërkesës së shoqërisë të datës 26.8.2025.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Rezulton se shoqëria ka kryer njoftimin për testimin e impiantit që në datën 26.8.2025, duke dëshmuar gatishmërinë për fillimin e prodhimit brenda afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të ERE-s. Si e tillë, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2, dhe me depozitim të testimit të veprës, shoqëria ka plotësuar kushtin e përcaktuar në pikën 3, të vendimit nr. 196/2025, ndaj vlerësohet që këto pika të shfuqizohen.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.

- Në kushtet kur pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 193/2024, të ndryshuar, janë përmbushur, vlerësohet se duhet të shfuqizohen.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.9.2024, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.9.2024, i ndryshuar, shfuqizohet;

b) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.9.2024, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “HPG Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti